

**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE E TUBERKULOZI  
NË SHQIPËRI GJATE VITIT 2023**



*MARS 2024*



## VËSHTRIM MBI EPIDEMIOLOGJINË E TUBERKULOZIT

Shqipëria edhe gjatë vitit 2023 bazuar në numrin e rasteve të reja me TB konsiderohet si vënd më incidencë të ulët (**10.9 raste të reja për 100,000 banorë**), rezistencë ë ulët baktëriale (1.7% mortalitet i ulët (rreth 0.25 për 100,000 banorë) dhe rezultate të suksesit të mjekimit të larta 89.7%

Gjatë vitit 2023 janë raportuar 302 raste me TB nga të cilat 272 (90 %) raste të reja dhe 30 raste (10 %) të ritrajtuar. Krahasuar me vitin 2022 është e njëjta situatë përse i përket klasifikimit të rasteve.

Raste e ritrajtuara përshijnë : recidivë 28 (9.3%), ndërprerë, 2(0.7%)

Grupmoshat më të prekura janë 15-24 vjec 16.6 % , 25-34 vjec (15.9% ), 55-64 (14.6%) dhe mbi 65 vjec (27.2%) .

Rastet me TB në grupmoshën 15-24 vjec gjatë vitit 2023 janë rritur me 2.9 %


Rastet me TB me moshë mbi 65 gjatë vitit 2023 është ulur me 4 % krahasuar me vitin 2022. Gjatë vitit 2023 rastet me TB në grupmoshat 25-34 dhe 45-54 vjec vazhdojnë të jenë në shifra të njëjta.

- Raste pulmonarë në total janë 231(76.5) (84.2 %) dhe raste ekstrapulmonarë në total janë 71(23.5) (15.8%). Raporti i rasteve pulmonare me rastet ekstrapulmonare gjatë vitit 2023 është i njëjte me raportin P: EP para pandemisë COVID-19. Gjatë periudhës së pandemisë dhe vitit 2021 dhe 2022 format pulmonare ishin në 90% të rasteve.
- Raporti i të sëmurëve TB sipas vendbanimit, në fshat apo në qytet, po ndryshon vazhdimisht në favor të qytetit. Gjatë vitit 2023 rreth 192 ose 63.6 % e pacientëve më TB banojnë në zonat urbane, ndërsa 110 ose 36.4 % banojnë në zonat rurale. Krahasuar me vitin 2022 rastet që jetojnë në qytet janë ulur me 9%.
- Meshkuj janë 167(65.2%) dhe femra ose 105 (34.8 %). Raporti meshkuj/fëmra në lidhje më TB e të gjitha formave vazhdon të jetë afësisht 2:1 në favor të meshkujve. Gjatë vitit 2023 vihet re një rritje me rreth 5% në femra krahasuar me vitin 2022.
- Grupet e rrishtit të rasteve me Tuberkuloz kryesisht emigrant, alkolizuar, përdorues drogë drogues, pacientë me HIV, personel shëndetësor, dhe nga popullata romë. Krahasuar me vitin 2022 janë rritur rastet me TB në grupet e rrishtit me 3 % kryesisht emigrant me kohë sezonale qëndrimi kryesisht në Gjermani.
- Rastet me TB të testuar për HIV /AIDS janë rreth 94% e pacientëve me Tuberkuloz ku kanë rezultuar 3 pacientë me co-infeksion TB/HIV. Në rritjen e testimit të pacientëve me TB një rol shumë të rëndësishëm ka dhe projekti i Fondit Global me sigurimin e testeve të shpejta për testimin e pacientëve me TB në çdo dispensari të rrethit. Personeli

i dispanserisë është trajnuar për kryerjen e testit të shpejt të HIV, nga stafi i programit Kombëtar të HIV.

- 59 raste TB ose 19.5 % janë zbuluar gjatë kontrollit në vatër të familjes së pacienteve me TB
- Raste me resistencë nga medikamentet tuberkulare janë 5 paciente ose 1.7% krahasuar me totalin e rasteve TB.
- Në lidhje me rezultatet e ekzaminimit bakteriologjik për vitin 2023 të gjitha rastet pulmonare janë me konfirmim bakteriologjik të mikroskopisë direkte dhe testimin me rapid test Genexpert 91% e rasteve TB janë testuar pranë Laboratorit të Referencës së TB. Për të bërë të mundur zbulimin në kohë të Tuberkulozit në të gjithë vendin është forcuar sistemi i transportit të mostrave të sputumit TB të sputumit nga niveli lokal në nivel qendror.
- Shpërndarja me e madhe e rasteve me TB është kryesisht në rrethin e Tiranë 47%, Durrës 6.6%, Lezhë 6.3%, Shkodër 6.3% dhe Lushnjë 5.3% të rasteve. Në rrethet e tjera vihet re një % me e ulët e rasteve me TB. Sic vihet re % me e madhe e rasteve të TB është në Tiranë.
- Shqipëria po i afrohet shumë qëllimit të saj për eliminimin e TB-së, edhe pse ende ka një rrugë të gjatë përpara, vendi tashmë ka një qasje të mirë tek shërbimet e kujdesit shëndetësor përsosur dhe në spitalet rajonale dhe bashkiake.


**Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve me TB në vite 2013-2023**



Pandemia e COVID-19 ka shkaktuar ndryshime thelbësore në kujdesin ndaj TB. Pacientët me tuberkuloz të diagnostikuar gjatë pandemisë COVID-19 shfaqën forma më të zgjatura pulmonare.

Problemet ekonomike dhe sociale që dolen nga pandemia sugjerojnë një rritje të vonesës së diagnostikimit dhe ashpërsisë së rasteve të diagnostikuara. Megjithatë, kontrolli dhe përdorimi i mjeteve mbrojtëse personale mund të ketë pasur një ndikim pozitiv në kontrollin e TB duke ndihmuar në zbutjen e transmetimit të sëmundjes në komunitet. Kështu, reduktimi i grumbullimeve masive si dhe përdorimi intensiv i maskave, mund të ketë kontribuar në uljen e rrezikut të transmetimit të TB gjatë pandemisë dhe pas izolimit. Rënia e numrit të popullsisë për shkak të emigrimit në vitet e fundit, sipas ekspertëve të tuberkulozit, mund të jetë një faktor që ndikon në uljen e rasteve të evidentuara me TBC. Rikuperimipas pandemisë po ecen me ritme të ngadaleta edhe pse vazhdimisht zhvillohen trajtime dhe monitorime rreth kontrollit të TB.


**Grafiku 2. Incidenca e rasteve të konfirmuara me TB sipas viteve (2008-2023)**



Gjate vitit 2022 dhe 2023 kemi një rritje të lehtë të rasteve me TB. Megjithatë nëse e krahasojmë me vitin 2019 para pandemisë kemi një rënie incidence të TB me 3,2 për 100000 banorë. Zgjerimi i shërbimeve të TB-së dhe sigurimi i disponueshmërisë së tyre në një gamë më të gjerë objektesh të kujdesit shëndetësor mund të përmirësojë aksesin në diagnostikim dhe trajtim, veçanërisht në zonat e largëta. Përmirësimi i aftësive diagnostikuese përmes investimit në teknologji të avancuara dhe trajnim profesional të kujdesit shëndetësor mund të rrisë shkallën e zbulimit të hershëm të rasteve TB.

Pacientëve u mungon motivimi për të kërkuar kujdes të hershëm, veçanërisht ata që jetojnë larg qendrave të kujdesit shëndetësor.

**Grafiku 3: Klasifikimi i rasteve TB (Raste të reja dhe të përsëritura )**



Gjatë vitit 2023 janë raportuar 302 raste me TB nga të cilat 272 (90 %) raste të reja dhe 30 raste (10 %) të ritrajtuar. Krahasuar me vitin 2022 është e njëjta situatë përse i përket klasifikimit të rasteve.

Raste e ritrajtuara përshijnë : recidivë 28 (9.3%), ndërprerë, 2(0.7%)


Grupmoshat më të prekura janë 15-24 vjeç 16.6 % , 25-34 vjeç (15.9% ), 55-64 (14.6%) dhe mbi 65 vjeç (27.2%) .

Rastet me TB në grupmoshën 15-24 vjeç gjatë vitit 2023 janë rritur me 2.9 %

Rastet me TB me moshë mbi 65 gjatë vitit 2023 është ulur me 4 % krahasuar me vitin 2022. Gjatë vitit 2023 rastet me TB në grupmoshat 25-34 dhe 45-54 vjeç vazhdojnë të jenë në shifra të njëjta.


Meshkuj janë 197(65.2%) dhe femra ose 105 (34.8 %). Raporti meshkuj/fëmra në lidhje me TB e të gjitha formave vazhdon të jetë afësisht 2:1 në favor të meshkujve. Gjatë vitit 2023 vihet re një rritje me rreth 5% në femra krahasuar me vitin 2022.

**Grafiku 4. Shpërndarja e rasteve sipas formave të sëmundjes së TB në vite, 2013-2023.**



Raste pulmonarë në total janë 231(76.5) (84.2 %) dhe raste ekstrapulmonarë në total janë 71(23.5) (15.8%). Raporti i rasteve pulmonare me rastet ekstrapulmonare gjatë vitit 2023 është i njëjte me raportin P: EP para pandemisë COVID-19. Gjatë periudhës së pandemisë dhe vitit 2021 dhe 2022 format pulmonare ishin në 90% të rasteve. Gjatë

**Grafiku 5 : Shpërndarja e rasteve TB**



Megjithatë theksojmë se raporti i të sëmurëve TB sipas vendbanimit, në fshat apo në qytet, po ndryshon vazhdimisht në favor të qytetit. Gjatë vitit 2023 rreth 192 ose 63.6 % e pacientëve më TB banojnë në zonat urbane, ndërsa 110 ose 36.4 % banojnë në zonat rurale. Krahasuar me vitin 2022 rastet që jetojnë në qytet janë ulur me 9%.

Per me shume informacion per TB:

- <https://www.who.int/teams/global-tuberculosis-programme/tb-reports/global-tuberculosis-report-2023>
- <https://shendetesia.gov.al/udhezuesit-e-tb/>
- <https://ccm-albania.al/>
- <https://www.who.int/campaigns/world-tb-day/2024>

# DIAGNOZA E SHPEJTË

E TUBERKULOZIT ËSHTË E  
DISPONUESHME DHE E REKOMANDUAR!

Pyesni mjekun tuaj për  
të kryer test të shpejtë  
- të rekomanduar nga  
OBSh, për të siguruar  
diagnozë dhe trajtim të  
hershëm.





Siguruar akses universal  
ndaj shërbimeve për  
tuberkulozin

Investuar në shërbimet  
e tuberkulozit, kërkim  
dhe inovacion



**NE MUND T'I JAPIM #FUNDTB duke:**



Promovuar  
bashkëpunimin  
ndërsektorial dhe  
përgjegjshmërinë



# TRAJTIMI PARANDALUES

## QË TUBERKULOZI TË MOS AVANCOJË NË SËMUNDJE



Nëse keni kontakt të ngushtë me një pacient me TB ose i përkisni grupeve me risk të lartë:

- ✓ Testohuni për infeksionin e TB.
- ✓ Nëse ju është përshkruar trajtim parandalues për TB, bëjeni mjekimin e plotë për t' u mbrojtur nga sëmundja.